



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Shërbimi Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

Data e shpalljes: 16.12.2025

Nr. i Prokurimit: "BQK 25 082 221"

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK	
Adresa: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: +383 38 222 055/451	

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Shërbime të përkthimit"
Lloji i prokurimit: Kontratë shërbimi
Vendi kryesor i realizimit: Prishtinë
Informacione të marrëveshje afatgjatë: Një vit me mundësi vazhdimi (në përputhje me nenin 43 të Rregullës për Prokurimin në BQK)
Variantet pranohen: Jo
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar e kontratës: 27,000.00 Euro/vjetore
Ndarja në Pjesë: Jo

III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjidhen kontraktuesit të cilët do të realizojnë në mënyrë profesionale për ofrimin e shërbimeve të përkthimit për nevoja të BQK-së sipas specifikave teknike dhe funksionale të parapara në Dosjen e Tenderit.

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim. **Vëmendje për operatorët ekonomik që t'i kenë parasysh kërkesat sipas tabelës në vijim rreth vendosjes së evidencave/dëshmime në ofertat e tyre.**

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 kur aplikohet) janë të obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	Kërkesa 1: Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. Evidenca 1: Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës i cili gjendet në dosjen e tenderit.
	Kërkesa 2: Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C. Evidenca 2: Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në Kërkesat 1, 2 dhe 3 të kësaj tablele. Kërkesa 3: Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium) Evidenca 3: Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohet si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	<p>përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë.</p> <p>Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK. Kurse kërkesat për kriteret e për zgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.</p>
<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë e profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6 të kësaj tablele.</p>
<p>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>n/a</p>
<p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve</p>	<p><u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku tri kontrata të natyrës se ngjashme përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2022, 2023 dhe 2024, përfshirë edhe 2025 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë).</p> <p><u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet të ofroj si dëshmi:</p> <p>a) certifikatat relevante të pranimit të shërbimit ose</p> <p>b) referencat që evidentojnë realizimin e shërbimit të tillë.</p>

<p>(kërkesat 7, 8, 9 dhe 10) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</p>	<p>Kërkesa 8: Metodologjia e përkthimit</p> <p>Evidenca 8: Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë një përshkrim të detajuar të metodologjisë që do të përdorin për kryerjen e përkthimeve, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikimin e procesit të përkthimeve (përfshirë kohën e përkthimeve të dokumenteve dhe materialeve të kërkuara brenda një dite, jave dhe fleksibilitetin e ofrimit të përkthimit për raste urgjente); • Kohën për ofrimin e përkthyesve simultant! • Masat për sigurimin e saktësisë dhe integritetit të të dhënave.
---	---

V Lloji i procedurës: “Procedurë e hapur”, sipas Nenit 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (dhjetor 2024).

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm” (në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimin në BQK)

VI.1 Nën kriteret:

Nën-kriteri	Pesha (në përqindje %)
Çmimi	50
Ekipi profesional dhe kualifikimet ²	40
Afati kohor i ofruar (për ditë pune)	10

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE PËR OFERTUESIT

<p>Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 26.12.2025, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.</p>
<p>Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 26.12.2025, ora 14:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.</p>
<p>Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të ofertave, data: 29.12.2025, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.</p>
<p>Takimi për hapjen e ofertave, data: 29.12.2025, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.</p>

² Staf i propozuar nga ofertuesi - CV, duke përfshirë: a) Kualifikimet akademike të anëtarëve të ekipit, certifikimet profesionale relevante të secilit anëtar të ekipit, dhe b) Përvojën e mëparshme në realizimin e punëve të ngjashme

Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 1,000.00 € (një mijë euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh nga data e hapjes së ofertave
Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertës.
Dokumentet me pagesë: Jo

VIII ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

IX ADRESA

Rr. “Garibaldi” 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763